



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 673/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Rustem Thaqi kryesues, Faton Ademi dhe Adnan Konushevc, anëtar duke vendosur lidhur me ankesën e Subjektit politik Lista e Pavarur - Bekim Jashari, paraqitur kundër Subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës, dega në Komunwn Skenderaj për shkak të keqpërdorimit të fletëvotimeve, për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës të datës 17 tetor 2021, në seancën e panelit të mbajtur më datë 20.10.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. PRANOHET pjesërisht e bazuar ankesa Anr.673/2021 e datës 18.10.2021, paraqitur nga Subjekti politik Lista e Pavarur – Bekim Jashari, paraqitur kundër Subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës, për shkak të keqpërdorimit në vendvotimin nr.2108B/02D, ashtu që **I NDALOHET** Gazmend Xhemailit me nr.personal 1170466345, Kryesues i Këshillit të Vendvotimit nr.2108B/02D, në Skenderaj pjesëmarrja në zgjedhje, si kandidat apo edhe si pjesë administrative e ndonjë organi zgjedhor për periudhën kohore, në kohëzgjatje prej 5 (pesë) vite, nga dita e marrjes se vendimit.

II. REFUZOHET e pabazuar, pjesa e ankesës me të cilën ka kërkuar që të përsëritet votimi, në Vendvotimin 2108B/02D.

A r s y e t i m

Me datë 18.10.2021, PZAP, ka pranuar ankesë nga Lista e Pavarur – Bekim Jashari, me të cilën pretendon se në vendvotimin nr.2108B/02D gjatë procesit të numërimit të votave janë evidentuar dy fletëvotime të pavulosura, njëra e pa plotësuar dhe tjetra e votuar për PDK, po ashtu në këtë vendvotim nuk ka pasur barazim të votave për kuvend komunal ku kanë ardhur edhe zyrtar të KQZ dhe nuk kanë mundur të barazohen. Parashtruesi i ankesës ka kërkuar që të bëhet përsëritja e votimit pasi që ka dyshime të mëdha për vjedhje të votave sipas sistemit të “trenit bullgar”. Ankesës i ka bashkangjitur deklaratën e anëtarit të KVV, Fahri Ramadani nga subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës.

PZAP, më datë 19.10.2021 i ka paraqitur Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kërkesë për përgjigje lidhur me ankesën Anr.673/2021 me të cilën ka kërkuar që t'i ofrojë PZAP-së Librin e Vërejtjeve për vendvotimin nr.2108B/02D, në Skenderaj duke i dhënë mundësinë që

të përgjigjet deri më datë 19.10.2021 në ora 15:00 si dhe përmes emailit zyrtar të PZAP-së është kërkuar dhënia e deklaratës nga ana e kryesuesit të vendvotimit nr.2108B/02D, në Skenderaj.

Duke vepruar sipas kërkesës së PZAP-së, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me datë 19.10.2021 ka paraqitur pranë PZAP-së Librin e Votimit për Vendvotimin nr.2108B/02D, në Skenderaj Formularin e Përputhjes se të dhënave dhe Rezultateve për Kryetar Komune, Formularin i Përputhjes se te dhënave dhe Rezultateve për Kuvend Komunal.

Po ashtu, sipas kërkesës së PZAP-it, me datë 19.10.2019 përmes emailit zyrtar të PZAP-së është pranuar edhe deklarata e Gazmend Xhemali, kryesues në vendvotimin nr.2108B/02D, në Skenderaj.

Paneli, pasi që shqyrtoj ankesën, në kuptim të nenit 117.3 të LZP-së gjeti se:

Ankesa është pjesërisht e bazuar.

PZAP, pas shqyrtimit të ankesës dhe provave të bashkangjitura, konstatoi se ankesa është pjesërisht e bazuar në pjesën që ka të bëjë se në vendvotimin lëndor janë dy fletëvotime të pavulitura, kjo është konstatuar nga deklarata e kryesuesit dhe anëtarit të Këshillit të Vendvotimit 2108B/02D. Andaj në raport me këto parregullsi paneli vendosi si në pikën -I-, të dispozitivit të këtij vendimi, bazuar në dispozitën ligjore të nenit 120 par.3, pika d), të LZP-së, në të cilin parashihet se: *“Në rast se ka ndodhur një shkelje e këtij ligji ose rregullave zgjedhore e cila e minon integritetin e zgjedhjeve PZAP-i mundet d) Ndalojë një individ të marr pjesë në zgjedhjet e mbajtura nën autoritetin e KQZ-së, si kandidat apo edhe si pjesë administrative e ndonjë organi zgjedhor, për një periudhë kohore që nuk u kalon gjashtë (6) vite”*. Lëshimet e pretenduara dhe të konstatuara nga paneli i atribuohen përgjegjësisë së kryesuesit të vendvotimit sipas nenit 74.10, pasi integritetit i procesit mbetet përgjegjësi e kryesuesit. *Me nenin 74.10 të LZP-së përcaktohet “KVV-ja është përgjegjëse për sigurimin e integritetit, sigurisë dhe të qetësisë në procesin e votimit dhe numërimit në Vendvotim nën mbikëqyrjen e drejtpërdrejtë nga KKZ-ja”*.

Në raport me pjesën refuzuese për urdhërimin e përsëritjes së votimit Paneli i vlerëson se mospërputhja e rezultatit konstatuar si më lartë nuk është bazë e mjaftueshme dhe me peshë në rezultat për të urdhëruar përsëritjen e votimit në vendvotimin e pretenduar, bazuar në nenin 117 paragrafi 3 dhe nenin 118, të LZP-së, ngase nuk janë ofruar dëshmi të qarta dhe bindës se ka pas parregullsi të asaj natyre për të ndikuar në vendimmarrje ndryshe në këtë rast, siç është vendosur në pikën -II-, të dispozitivit të këtij vendimi.

Nga arsyet e lartcekura paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr.673/2021 më datën 20.10.2021.

Kryesuesi i Panelit
Rrustem Thaqi



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 3 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.